



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 19.4.2021, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Alban Hyseni, Doarsa Kica- Xhelili, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Blerta Deliu- Kodra, Hajdar Beqaj, Besnik Tahiri, Erxhan Galushi dhe Ljubinko Karaxhiq.

Mbledhjen e kryesoi: Adnan Rustemi, kryetar i komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Amire Qamili- BIRN; Valmira Saraçi- RTK; Ridvan Slivova-Telegraf; Marigona Brahimi- KOHA; Donika Osmani-RTV21; Aurora Mullatahiri-GLPS; Erduan Zeqiri-Kosovapress; Urim Krasniqi-BIRN; Faton Fetahu- GP-PDK; Zhujë Binakaj- AAK dhe Driton Paçarada-Koha ditore.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më datë 2.4 dhe 3.4.2021;
3. Diskutim lidhur me aktivitetet e komisionit;
4. Shqyrtimi i Përfundimit nr.08-P-005, i datës 14.4.2021;
5. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për shqyrtim me urgjencë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.06/L-091;

6. Caktimi i një anëtari në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të Dënuarve dhe të ish-të Përndjekurve Politikë;
7. Caktimi i një anëtari në Komisionin Qeveritar për Kompensimin e Viktimave të Krimit;
8. Formimi i grupit punues për përgatitjen e tekstit të konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 2.4 dhe 3.4.2021

Kryetari konstatoi se u miratuan procesverbalet e mbledhjeve, të mbajtura më datë 2.4. dhe 3.4. 2021, pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me aktivitetet e komisionit

Kryetari, tha se është e rëndësishme që Komisioni për Legjislacion të përmbushë mandatin që ka, qoftë në mbikëqyrjen parlamentare, në shqyrtimin e ligjeve, por edhe në monitorimin e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por në mungesë të programit legjislativ, nuk mund të fillojmë aktualisht punën, theksoi z. Rrustemi. Më pas, ai diskutoi edhe për orarin e punës së komisionit, në parim, duke propozuar ditën e martë dhe të mërkurë, si opsion. Gjithashtu, njoftoi anëtarët e komisionit për takimin që ka pasur me organizatën “Demokraci Plus”, ku tha se ata kanë shprehur gatishmëri për të mbështetur Komisionin për Legjislacion. Një njoftim tjetër ishte edhe për materialet për mbledhje të komisionit, ku tha se ato do të shpërndahen vetëm në mënyrë elektronike. Kjo si rrjedhojë e një vendimi të Komisionit për Buxhet dhe Transfere të legjislaturës së kaluar.

Hajdar Beqa, sa i përket planit të punës së komisionit, tha se meqë Qeveria ende nuk e ka sjellë planin legjislativ, komisioni mund të fillojë punën me një propozim-draft të përpiluar nga administrata, ndërsa për ditën se kur do të mbahen mbledhjet e komisionit, tha se dita e martë do të ishte më e përshtatshme.

Besnik Tahiri, theksoi se komisioni do të ketë shumë punë, por nuk është mirë që të ketë situata të befasishme, si ajo me Ligjin për zgjedhjet për shkak se trajtimi i ligjeve duhet të jetë shumë më i thellë tha deputeti Besnik Tahiri. Gjithashtu i dha mbështetje gatishmërisë nga “Demokraci Plus”, për të ndihmuar komisionin, por shtoi se është mirë të sqarohet se në çfarë fushe do të bëhet kjo mbështetje.

Doarsa Kica-Xhelili, lidhur me caktimin e ditës së mbajtjes së mbledhjeve të komisionit, propozoi që fillimisht kryetarët e komisioneve të dakordohen mes vete për ditën e mbledhjeve të

komisioneve të përhershme e pastaj komisionet e përkohshme, në përputhje me atë sugjerim, të caktojnë ditën e tyre, në mënyrë që të dihet edhe agjenda e anëtarëve, të cilët janë të përfshirë nëpër komisione.

Blerta Deliu-Kodra, tha se pajtohet me propozimin e znj. Kica-Xhelili, që të ketë dakordim, sidomos për komisionet e përhershme, ndërsa sa i përket organizatës “Demokraci Plus”, tha se është një iniciativë e mirë, duke pasur parasysh tentativën që u bë për plotësim-ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet, sa ka qenë e zëshme shoqëria civile dhe mospërfshirja e saj në amendamentimin e ligjit.

Driton Selmanaj, për çështjen e organizmit të mbledhjeve, tha se Komisioni për Legjislacion është komisioni më i rëndësishëm në Kuvend, prandaj edhe komisionet tjera duhet t’i përshtaten këtij komisioni. Ai propozoi që dita e martë të jetë ditë e mbajtjes së mbledhjeve, ndërsa sa i përket mbështetjes nga shoqëria civile, tha se Komisioni për Legjislacion do të jetë i hapur, jo vetëm në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve, por edhe në fusha tjera.

Alban Hyseni, ngriti çështjen e hapësirës apo sallave për mbajtje të mbledhjeve të komisioneve. Ai tha se për shkak të rëndësisë së këtij komisioni, është e rëndësishme që edhe hapësira të jetë e përshtatshme, që të monitorohet puna e komisioneve, si nga mediat, ashtu dhe nga shoqëria civile. Ai u pajtua që, dita e martë, të jetë dita kur do të mbahen mbledhjet e komisionit.

Kryetari, pas diskutimeve, tha se kemi pajtimin e dy deputetëve, me propozimin e z. Beqa, që mbledhjet të mbahen ditën e martë dhe pajtohet me këtë propozim, në parim, por gjithmonë duke lënë mundësinë që të konsultohen edhe me anëtarët tjerë të komisionit, të cilët janë të angazhuar në komisione tjera. Ndërsa, sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile, theksoi se komisioni do të ketë bashkëpunim të ngushtë, gjithnjë në funksion të përmirësimit të infrastrukturës ligjore, për aq sa ka përgjegjësi Komisioni për Legjislacion.

4. Shqyrtimi i Përfundimit nr.08-P-005, i datës 14.4.2021

Kryetari theksoi se Kryetari i Kuvendit, në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, ka kërkuar nga Komisioni për Legjislacion, që të fillojë punën për përfundimin e Propozim-Rregullores së re të Kuvendit, prandaj nëse ka pajtueshmëri, të formohet një grup punues, i cili do të punojë draftin e parë të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Besnik Tahiri, tha se ka shumë vite që ka një angazhim, ku si rrjedhojë, janë edhe disa drafte të kësaj rregulloreje, por që nuk janë miratuar në Kuvend, për arsye të mungesës së 2/3 të votave. Pra, opozita në atë kohë, nuk i ka dhënë mbështetje dhe do të ishte mirë që komisioni t’i shikojë pikat, ku në të kaluarën ka pasur kundërshtime, në mënyrë që këto pika pastaj të trajtohen, sepse nuk mendoj që do të kishte nevojë që të nisesh nga fillimi për temat, të cilat ka pasur pajtueshmëri në grupet parlamentare. Ai, më tej, tha se Rregullorja duhet të shtyhet përpara dhe ky proces

duhet të ketë edhe një afat kohor, duke theksuar se kjo rregullore duhet të lehtësojë punën e Kuvendit e jo ta pengojë atë.

Hajdar Beqa, tha se në Legjislaturën VI, në këtë drejtim, është punuar shumë, ku ka pasur edhe një dakordim të të gjithë spektrit politik, por që kjo rregullore ka kaluar vetëm në lexim të parë, prandaj do të ishte një arritje e madhe për Komisionin për Legjislacion, nëse arrihet që Rregullorja të kalojë në dy leximet, theksoi z. Beqa.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se për hartimin e Rregullores së Kuvendit, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për hartimin e Rregullores së Kuvendit

1. Grupi i punës ka këtë përbërje:

Adnan Rrustemi, kryesues,
Blerta Deliu- Kodra, anëtare,
Driton Selmanaj, anëtar,
Besnik Tahiri, anëtar,
Erxhan Galushi, anëtar,
Ljubinko Karaxhiq, anëtar.

5. **Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për shqyrtim me urgjencë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.06/L-091**

Kryetari, në fjalën e tij, tha se nga Ministria e Drejtësisë është sjellë kërkesa për shqyrtimin me urgjencë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale. Ai, më tej, sqaroi para anëtarëve përmbajtjen e projektligjit, duke pasur parasysh rëndësinë që ka gjykimi në mungesë dhe secili prej nesh e kupton ndryshimin, sado teknik që duket, por me efekte të rëndësishme për një çështje të ndjeshme në vendin tonë.

Blerta Deliu-Kodra, tha se kjo qasje e ndryshimit ad-hoc, është qasje joprofesionale dhe jo e duhur, sidomos kur flasim për një bazë ligjore të tillë, e cila kërkon një trajtim serioz dhe profesional. Mendoj se nuk duhet të ketë nguti në shqyrtimin e plotësim-ndryshimeve të tilla, që kanë peshë dhe rëndësi për institucionet e vendit, theksoi deputetja Deliu-Kodra.

Kryetari, në këtë pikë nuk do të duhej të jemi të ndarë, por duhet të ketë një pajtueshmëri të plotë, ndërsa mendoj se jemi të vonuar, sa i përket adresimit të krimeve të luftës në Kosovë, prandaj nuk ka të bëjë me nguti, theksoi deputeti Rrustemi. Në fund, tha se nuk duhet t'i jepet kahe politike

kësaj çështje të rëndësishme, prandaj edhe ftoi anëtarët e komisionit që ta mbështesin këtë projektligj, në mënyrë që t'i hapet rrugë Prokurorisë Speciale, që të bëjë punën e saj.

Blerta Deliu-Kodra, sërish mori fjalën dhe tha se nuk është mirë që të keqpërdoret pozita e kryetarit të komisionit, me konstatime të gabuara. Më tej, shtoi se mbështesin hetimin dhe gjykimin në mungesë të krimeve të luftës dhe jo vetëm, por nuk pranojnë që ky komision dhe kryetari i komisionit ta politizojë një kërkesë të tillë, duke shtuar se sot situata është e tillë, për shkak të gabimeve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Kryetari, duke iu përgjigjur deputetes Blerta Deliu-Kodra, tha se edhe pse Ministri i Drejtësisë iu ka takuar juve, asnjëherë nuk është ngritur kjo çështje, prandaj është absurde që të fajësohet Lëvizja Vetëvendosje, kur dihet se çështjen e gjykimit në mungesë e kanë ngritur deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje.

Driton Selmanaj, tha se kjo temë nuk na ndan, prandaj edhe duhet të kihet kujdes nga gjuha e cila përdoret rreth kësaj teme. Ai shtoi se nuk sheh urgjencë për trajtimin e këtij projektligji, sepse me urgjenca të tilla nuk po arrihet të bëhen ligje të mira. Më tej, shtoi se asnjë parti politike shqiptare nuk është kundër trajtimit të kësaj çështjeje.

Kryetari, tha se kjo është një kërkesë specifike, sepse po flitet për një shtet, i cili jo vetëm që ka qasje armiqësore ndaj Kosovës, por edhe ndaj një shteti, i cili nuk ka qëndrim distancues ndaj krimeve të bëra në Kosovë dhe i cili strehon kriminelët e luftës.

Hajdar Beqa, tha se Partia Demokratike e Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj, duke kërkuar që Qeveria të sjellë Kodin e Procedurës Penale, të kompletuar, në mënyrë që të jepet kontributi me gjithë aktorët tjerë, të cilët përcjellin punën e komisionit.

Doarsa Kica-Xhelili, tha se luftimi i krimeve të luftës, prej fillimit, ka qenë konsensus politik, por po kërkohet ngutshmëria e këtij trajtimi, sepse nuk mund ta riaktivizojmë një proces hetimor, por mund t'i zgjasim afatet hetimore, derisa ato nuk kanë përfunduar. Pra, nuk ka të bëjë me ndonjë agjendë politike, por me faktin se në qoftë se presim deri në ardhjen e Kodit të Procedurës Penale, në aspekt kohor, pamundësohet që Prokuroria Speciale të adresojë rastet, të cilave do t'iu kalojë afati hetimor. Në anën tjetër, është e rëndësishme të ceket se edhe vetë gjykimi në mungesë për krime të luftës nuk po mund të materializohet, pra me kërkesë të Prokurorisë Speciale, mundësia e vetme e materializimit është në qoftë se e rikthejmë aspektin e pezullimit të hetimit.

Besnik Tahiri, tha se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është për zbardhjen e krimeve të luftës dhe i jep mbështetje kësaj çështjeje. Problemi është se për këto tema nuk po zgjidhet komunikimi publik dhe politik, dhe në këtë drejtim, duhet të kihet kujdes, sepse kjo temë nuk na ndan, por përkundrazi na bashkon.

Blerta Deliu-Kodra, nuk është mirë që kryetari i komisionit t'i japë kahe diskutimeve dhe qëndrimit tim, si deputete, sepse që në fillim theksova që, Partia Demokratike e Kosovës e

mbështet gjykimin në mungesë, gjithashtu mbështesim kërkesën e Prokurorisë Speciale, që krimet në mungesë të gjykohen.

Hydajet Hyseni-Kaloshi, tha se duke qenë komision i veçantë në gjithë qasjen e veprimtarisë parlamentare, pajtohem që këtu të mos ketë aspak politikë, por të ketë qasje parimore e juridike. Ajo që e justifikon, deri diku, qasjen e ngutjes së trajtimit të këtij projektligji, është se ka qenë një propozim i hershëm, i cili është përafuar, por për arsye që dihen, nuk është miratuar, dhe duke ditur që nuk jemi në fazën e shqyrtimit përmbajtjesor të ligjit, është mirë të miratohet parimisht, por duke lënë mundësinë për ndryshime, aty ku shihet e nevojshme.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se me dhjetë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Propozim-Vendim

1. Shqyrtimi i parë dhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.06/L-091, bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15.7, nenin 56, paragrafin 1, me nenin 57, paragrafët 3, 5, 8 dhe 9 dhe nenin 64, paragrafi 4, të Rregullores së Kuvendit.
2. Pas miratimit në lexim të parë, të ngarkohen Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime, sipas afateve të përcaktuara nga Kuvendi.
6. **Caktimi i një anëtari në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të Dënuarve dhe të ish-të Përndjekurve Politikë**

Meqë në këtë pikë nuk kishte diskutime, kryetari konstatoi se me propozim të deputetes Blerta Deliu-Kodra dhe me vota unanime, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi, caktohet anëtar në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të Dënuarve dhe të ish-të Përndjekurve Politikë.

7. **Caktimi i një anëtari në Komisionin Qeveritar për Kompensimin e Viktimave të Krimet**

Artan Abrashi, tha se meqenëse edhe në legjislaturën e kaluar ka dhënë kontribut, duke qenë anëtar në këtë komision, propozoi deputetin Alban Hyseni, që të jetë anëtarë në Komisionin Qeveritar për Kompensimin e Viktimave të Krimet.

Driton Selmanaj, tha se do të ishte mirë që të ketë diversitet të përfaqësimit në këto komisione, prandaj në këtë drejtim, propozoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, që të jetë anëtare në këtë komision.

Alban Hyseni, tha se qëllimi nuk është që vetëm ne të përfaqësohemi nëpër komisione, prandaj tërhiqem dhe liroj vendin për deputeten e propozuar, znj. Blerta Deliu-Kodra.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se me propozim të deputetit Driton Selmanaj dhe me vota unanime, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Deputetja Blerta Deliu-Kodra, caktohet anëtare në Komisionin Qeveritar për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

8. Formimi i grupit të punës për përgatitjen e tekstit të konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile

Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit me procedurat e përzgjedhjes së dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile, dhe meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se për hartimin e tekstit të konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për përgatitjen e tekstit të konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile

1. Formohet grupi i punës në përbërje:

Alban Hyseni, kryesues,
Hajdar Beqa, anëtar,
Driton Selmanaj, anëtar,
Besnik Tahiri, anëtar,
Erxhan Galushi, anëtar, dhe
Ljubinko Karaxhiq, anëtar.

9. Të ndryshme

Hajdar Beqa, tha se nga mediat kanë kuptuar që ish- gjyqtari i EULEX-it, z. Malcolm Simons, iu është drejtuar komisionit, që të raportojë për padrejtësitë që janë bërë në kohën e EULEX-it.

Në këtë drejtim, ai kërkoi që letrat që vijnë në komision, t'u shpërndahen të gjithë anëtarëve të komisionit.

Kryetari, tha se ka pranuar një kërkesë të tillë, por e cila iu është drejtuar Kuvendit, respektivisht Kryetarit të Kuvendit dhe Sekretarit, por që kam qenë i njoftuar edhe unë. Ky është edhe dallimi nga kërkesa e mëparshme, ku iu është drejtuar direkt kryetarit të komisionit, prandaj edhe nuk është shpërndarë, përndryshe të gjitha materialet që vijnë në adresë të kryetarit e që i drejtohet komisionit, do të shpërndahet me kohë, te secili anëtar i komisionit dhe në momentin që autorizohet komisioni, do të trajtohet kjo çështje.

Driton Selmanaj, tha se kam përshtypjen se duhet të kemi shumë kujdes në mandatin tonë, duke mos guxuar të dalim përtej këtij mandati dhe nuk mendoj se Komisioni për Legjislacion mund të shndërrohet në instancë gjyqësore për njerëz të cilët kanë kryer apo nuk kanë kryer punën si duhet nëpër mekanizma ndërkombëtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,
Adnan Rrustemi
